



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:171023

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06229652

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku dhe me praktikanten e kësaj gjykate Djellza Makolli, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.K me vendbanim në fshatin P..., komuna Ferizaj për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodi 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm me numër PP/II.nr.1239/22 të datës 24.01.2023, jashtë seance, me datë 30.09.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

F.K nga i ati I. dhe e ëma S..., e vajzërisë B..., i lindur me datë ... në Prishtinë, me vendbanim në fshatin P..., komuna Ferizaj, me numër personal ..., i pa martuar, me profesion punëtorë fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale:

REFUZOHET AKUZA

Sepse

Me datë 27.11.2018 , rreth orës 21:30, në rrugën “...” në Ferizaj, pas një mosmarrëveshje verbale, i pandehuri me dashje i ka shkakuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit N.K , në atë mënyrë që fillimisht e ka sulmuar fizikisht në pjesën e epërme të trupit pastaj duke e goditur me grushta kryesisht në kokë dhe shqelma deri sa i dëmtuari ishte rrëzuar në tokë, me ç’rast të

dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjekoligjore te datës 26.07.2022.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale **Lëndim i lehtë trupor** nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.
- I dëmtuari N.K nga fshati P... komuna Ferizaj për realizimin e kërkesë pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.
- Shpenzimet e procedurës penale për këtë çështje juridiko-penale mbeten në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 24.01.2023, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1239/22, kundër të pandehurit F.K për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Më datë 26.06.2023, kjo lëndë penale është bartur nga gjyqtarja M.Sh. tek gjyqtari Dardan Maloku. Gjykata ka caktuar seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 05.06.2024, 11.07.2024 dhe 05.09.2024 mirëpo prezenca e të pandehurit nuk është arritur të sigurohet.

Me datë 09.09.2024, Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, përmes parashtrësës – njoftimit me numër PP/II.nr.1239/2022, e ka njoftuar gjykatën se koha e saktë e kryerjes së veprës penale siç përshkruhet në aktakuzë është data 27.11.2018 dhe se e bëjnë përmasimin e një gabimi teknik ashtu që në vend të kualifikimit juridik të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës duhet të jetë Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodi 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës.

2.Parashkrimi i veprës penale

Duke pasur parasysh se vepra penale sipas aktakuzës pretendohet se është kryer më datë 27.11.2018 atëherë, në këtë periudhë kohore ka qenë në fuqi Kodi 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi me datë 1 janar 2013, dhe kjo vepër penale ka qenë e

sanksionuar nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me nen paragrafin 1.4 i Kodi 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, i cili nen përcakton se: *“Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në (1) vit. ”*

Neni 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i KPRK-së lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale përcakton se: *“dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë”*. Gjithashtu, neni 107 paragrafi 8 i KPRK-së përcakton se: *“Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.”*

Andaj, duke pasur parasysh se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri pretendohet se është kryer me datë 27.11.2018, atëherë afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga data 27.11.2018, andaj duke pasur parasysh se vepra Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së është e dënueshme me gjobë ose me burgim prej deri në (1) vit, atëherë afati i parashkrimit absolut ka arritur me kalimin e afatit prej 4 viteve, rrjedhimisht nga data 27.11.2018 e deri më datë 27.11.2022.

3. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 3 i KPP-së, përcakton se: *“Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jokompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente”*. Andaj, pasi që është refuzuar akuza ndaj të pandehurit, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. I dëmtuari N.K nga fshati P..., komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesë pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko – civil.

4.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Neni 453 paragrafi 1 i KPP-së, përcakton se: *“Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449 paragrafi*

2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”. Andaj, pasi që është refuzuar akuza ndaj të pandehurit, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2023:021961, më datë 30.09.2024

Praktikante,
Djellza Makolli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.